

DEA KARAKAÇI

**PENA DHE VIZIONET E SHKRIMTARIT
DOM NDOC NIKAJ NË GAZETAT “KOHA”, “BASHKIMI”,
“BESA SHQYPTARE” DHE “ZANI I SHKODERS”**

Dom Ndoc Nikaj, ai që botoi të parin roman në gjuhën shqipe, “Marcia”, pos tjerash shquhet edhe si publicist, si botues i gazetave me emër në prag e pas shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë, “Koha” - “Bashkimi” e më pas dhe “Besa shqyptare” e “Zani i Shkoders”, të cilat luajtën një rol të rëndësishëm në zgjimin e ndërgjegjes kombëtare dhe në ndriçimin e shumë problemeve që shqetësonin shoqërinë e kohës. Edhe pse me një rreze veprimi të trajtimit të tyre kryesisht në trevën e Veriut, ato patën ndikim kombëtar. Në hapat që hodhi në rrugë të publicistikës shqiptare, kushdo që shfleton gazetën e mësipërme, ku ai që publicist, redaktor, drejtor gazete e pronar shtypshkronje, ndjen të rrahë zemra e një atdhetari.

Ndryshimet politike në krye të perandorisë turke në dekadën e parë të shekullit të kaluar sollën atë që si shumëkush, edhe Dom Ndoc Nikaj e kishte ëndërruar: lirinë konstitucionale (1908) që lejonte shkrimin e botimin në gjuhën amtare. Themeli për një qëllim të tillë që hedhur prej vitesh, kur nën petkun e reklamave të vogla tregtare u arrit të futej një pedalinë bashkë me germat, por që që e pamjaftueshme për të përmbushur misionin e tyre në kushtet e reja. Ndaj dhe, me ndihmën e At Gjergj Fishtës, Dom Ndoci me financim të tij, në vitin 1909, arriti të sjellë nga Budapesti i Hungarisë një makinë shtypi me familjet e germave, të përshtatshme për shtypjen e ndonjë libri a të ndonjë fletoreje (gazete), kuptohet në fillim me tirazh modest, deri në 80 kopje maksimumi, pasi edhe njerëzit që dinin të lexonin në shqip ishte i kufizuar, në elitën fetare e intelektuale. Me sjelljen e makinerisë, germave, bojës, letrës etj., Nikaj krijoi shtypshkronjën e tij të cilën e pagëzoi me emrin

“Nikaj”. *“Megjithëse pronari i kësaj shtypshkronje ishte klerik, ajo ishte e para shtypshkronjë publike në qytet”*¹.

Karriera publicistike e Dom Ndoc Nikës zyrtarisht nis qysh më 1 kallnuer (janar) 1910 kur arrin të nxjerrë edhe numrin e parë të gazetës së përjavshme “Koha”, nën siglën *“Kujdeson punët kombtare e t’ditunis”*².

Në numrin e parë dhe të vetëm të kësaj gazete me këtë emër, pas urimit me shkronja korsive të mëdha që botuesi u bën lexuesve për Vitin e Ri, boton një artikull redaksional me titullin e gazetës “Koha”, i cili, me siguri, gjykuar edhe në bazë të stilit, fjalorit, ndërtimit sintaksor të fjalive, etj., duhet të jetë i shkruar nga Dom Ndoc Nikaj. Argumentimi që autori i kryeartikullit, kushdo qoftë ai, është jo vetëm impresionues, por edhe i kthjellët në parashtrimin e arsyeve se përse jo dje por sot, koha thirri në skenë “Kohën”. *“E pse na nuk kena mui të parannej me qitë n’shesh një fletore? Pse?!...Pse nuk ishte koha. Ishin at herë kohë shterngimesh per gjith shka mujte me vjeftë per me çilë mënnen e me mnerr e me t’drithuna mërreshin aso kohe fletoret e hueja, josë me i vojtë mënia kuej me qitë një fletore t’veten! N’Giuhe Shqype!!” Por koha e shtyyn kohen e aj sunnim u permys prejë një tjetrit. Ky synnim i rii n’a thotë se erdh koha me folë çiltas e lirisht, me msye faqas, me i dalë kunnruell punve t’paa ulla, me kenë një e vllazen, me çilë shtypshkroje e me çpallë fletore me lirii”*³.

Nuk dihen saktësisht motivet e arsytet, por në numrin pasardhës, kjo gazetë del me emër tjetër, “Bashkimi”, mbase një qasje me shoqërinë me të njëjtin emër ku Nikaj bënte pjesë e që asokohe pat bërë emër. Ndërrimin e emrit të gazetës na e lë pezull edhe vetë Dom Ndoci, pavarësisht se i drejtohet lexuesit me një “Diftim”, në substancë të të cilit është *“Per do arsylene t’ forta, e n’vënn me i thanë “KOHA”, sot mrapa kaa me u êmnue “BASHKIMI”. ...Ky nnrim, kena uxdaje kaa me kenë i vjefshem pse tuj lân êmnimin “KOHA” poi lâmame shteg një Fletores ree t’perjavshme që ka me*

¹ Revista “Phoneix”, viti 2003, Shkodër, f. 5.

² Gazeta (Fletorja) “KOHA”, vjeta e I, n’Shkoder, 1 kallnuer 1910, nr. 1, f. 1.

³ Po aty.

*dale (kena uzdaje) fort shpejt; "BASHKIMI" kaa me dale n'e Diele e "KOHA" n'e Ejte e, kshtu knnej, kan me kenë dy Fletore n'javë"*⁴.

"Bashkimi" ofroi një larmi tematike për të plotësuar shijet e kërkesat e shtresave të ndryshme shoqërore të interesuara e të lidhura me çështjen kombëtare. "*Gazeta doli me katër faqe dhe vazhdoi të qarkullojë deri në vitin 1912*"⁵. Artikujt e botuar në faqet e saj sillnin zhvillimet politike të kohës, trajtonin çështje kombëtare, shoqërore, kulturore, letrare, ekonomike etj. Edhe pse një hark kohor i shkurtër i ekzistencës së saj, Nikaj si publicist, erdh duke e pasuruar përvojën, po më së shumti për të përmbushur dhe kërkesat në rritje të lexuesve.

Qysh në kryeartikullin e parë të "Bashkimit" Dom Ndoc Nikaj e shfaq atdhetarizmin e tij përmes shkrimit që i kishte kushtuar një pjesë të mirë të jetës së tij të deriatëhershme, duke i vënë titullin "Giuha shqype". Veçse në të rreh zemra e një shqiptari, ndjehet dhe aftësia e tij për të bërë pronë të lexuesit rëndësinë e shkrimit dhe të shkollimit në gjuhën amtare, krehjen e saj nga fjalët e huaja, sidomos turqisht, italisht, greqisht e shkjenisht pa qenë nevoja. "*Giuha shqype është giuhë e vjeter e hiishme e nuk është e vrashte n'shqyptim por shkon amel sidomos n'gojë t'atyne që e flasin të kulluet e t'paa perziëme me fjalë të hueja.*"⁶

Temës së gjuhës shqipe, të së shkruari dhe shkollimi, në gazetën "Bashkimi" e më pas edhe tek "Besa Shqyptare" e "Zani i Shkodrës", do të kemi disa trajtesa, madje edhe në poezi e esse, duke zënë të plotë faqen e parë të "Bashkimit" më 22 shkurt 1911.

⁴ Gazeta "Bashkimi", vjeta I, n'Shkoder, 9 n'Kallnuer 1910, nr. 2. Pra, edhe duke vendosë numrin e gazetës nën emrin e ri "Bashkimi", botuesi e konsideron atë si vazhdim pikë për pikë i gazetës me emrin e mëparshëm "KOHA", veçse nën emër të ri.

⁵ T. Osmani: "Tradita kulturore-gjuhësore në veprën "Kujtime t'nji jete t'kalueme" të Ndoc Nikajt, kumtesë e botuar në vëllimin "Autorët e trevës së Veriut të traditës në vështrim gjuhësor, letrar dhe historik", Shkodër 2007, f. 11.

N. Nikaj: "Kujtime...", vep. cit, f. 97.

Revista "Phoneix", viti 2003, Shkodër, f. 5.

⁶ "Bashkimi", gaz.e cit., më lart, po aty.

Edhe pse që në fillimet e saj publicistika e Nikajt, ai pat një orientim të qartë në ato që do trajtonte, do ta vinte theksin në problematikat kryesore dhe, në qoftë se e nisi me “Gjuhën shqype” që në hapin e parë të “Bashkimit”, më pas të “Shkronjave latine” me autor Ndoc Çobën, nuk kishte se si në numrat pasardhës ai të mos e mbushte faqen e parë me shkrimin “Lirija”, duke e parë gjuhën dhe lirinë si fjalë sinonimike e për të cilat ai, si atdhetar, s’kursehej të rrezikonte gjithçka edhe nga jeta e tij. Pas trajtimit që i bën lirisë si nocion e realitet historik, e mbyll shkrimin me këto fraza emblematiche: *Lirija nuk kaqyrë besimet e është si për Muhamedan, si për t’Kshenë, si për katunnarë, si për pasanikë ashtu për t’vorfen, e gjikimet do të bahen çiltas, paa mshehtii e paa ngatrrasa. Kjo është Lirija!*⁷.

Në numrat pasardhës tërheq vëmendjen edhe kryeartikulli me titull “Çfarë kombit jemi?”, ku hapur e qartë, shprehet krenaria për gjenezën e të qenit shqiptar. Profesionalizmin e tij autori, që edhe pse me iniciale, ka shumë gjasa të jetë vetë Ndoc Nikaj, e shpreh qartë në pasazhin e zhvillimor të kombit, të rrugës drejt tij që ai duhet të ndjekë: *“Le t’gëzohena praa, vellazen Shqyptarë, për kombësinë t’onë, por n’anë tjetër t’mundohena me i dhanë shkas veedit, tuj punue e tuej aratisë nuret e mira që t’shpërthejnë e t’lulzojnë, e tuej u mundue me hjekë e me shporrë veset e këqija. Udhë e vetme për me lulëzue komsien t’onë është këndimi e mësimi e këta fitohen me shkolla, por me shkolla n’gjuhë t’onë”*⁸.

Spektri tematik i kësaj gazeta sa vjen e zgjerohet, madje duke prekur edhe tema tabu të deriatëhershme. Mjafton të citojmë disa prej tyre për t’u bindur se ç’kërkonte të rrënjosë kjo gazetë në ato lexues që e shfletonin atë e që përmes tyre edhe ata që nuk e merrnin të përhapëshin ide të reja të ardhmërisë e që Europa i kish tejkaluar, si psh “T’rritunit e fëmijve”, “T’rritunit e vajzave”, “Dashtënija”, “Vllazënija”, “Puna”, “Lufta”, etj.

Faqet e kësaj gazete janë hapur për shumë bashkëpunëtorë (edhe pse ato me iniciale të padeshifrueshme) e për shumë probleme, siç

⁷ Gaz. “Bashkimi”, e cit., 23 Kallnuer, nr. 4.

⁸ Gaz. “Bashkimi” e cituar, vjeta I, N’Shkoder, 17 n’Prill, 1910, nr. 16.

edhe i cekëm, u pasurua deri në letra të ardhura, reklama, histori, njoftime zyrtare, letërsi origjinale e përkthime të autorëve klasikë e bashkëkohës, urbanistikë, humor, udhëpërshkrime, hera-herës edhe lajme të javës e replika. Madje edhe urime për festa fetare e evenimente të tjera të rëndësishme e me peshë në zhvillimet bashkëkohëse, qytetare e religjionare.

Nën nënshkrimin "Shkodrani", botohet një letër që për mua përcjell një vijimësi të artikullit të mëhershëm për gjuhën shqipe:

"I ndershmi direktor i gazetës "Bashkimi",

*Mbasi fletorja e juëj për qellim me kujdesu e punët kombtare mue s'po m'xehe paa e diftue një t're t'shkurtun por punë e madhe. "Nji leter që marrim prej Durcit, po na lajmëon se n'mejtep t'atij gjytet, ku deri sot kenka msue shqypja me shkronjat e saja, paskan dhanë êmen që mas sodit t'msohet me shrola (arfe) arabishte, e se zoti Sali Nivica, msojsi i shqypes n'at mejtep paska dhanë lajmin (istafin) tuj thanë: Se nuk dii me e msue shqypen me ato arfe. Kena uzda jë se qeveria nuk ka me dhanë shtërngime për me msue gjuhen t'onë me shkronja që nuk i gjejin kurrsesi nevojës t'zhdrivillimit t'gjuhes Shqype"*⁹.

Mbase në vijim a në ndihmë të një problematike të tillë, botuesi hedh një tjetër hap, duke vendosur në një vend të dukshëm të gazetës "Një njoftim", ku, mes tjerash, lexojmë: *"Për ato që dishroine me u msue me kndue me shkronja t'ona po i vemë ktu shkroi"*¹⁰ (Botuesi pas këtij shënimi, më së pari ka vendosur shkronjat shqipe e në krah të secilës shkronjat korresponduese arabe. Një njoftim të tillë ai e vazhdon në disa numra të gazetës-shënimi im, D.K.)

Në numrat pasardhës të gazetës, një veprim të tillë Nikaj vjen duke e zgjeruar e pasuruar, duke pasur parasysh edhe rritjen e lidhjeve e të këmbimeve të ndërsjella tregtare me disa vende të huaja, pasi në vijim ai, që nga nr. 32 i 7 gushtit 1910 e më pas nis të botojë në një faqe e në të njëjtin vend të pasardhëses fjalë të përdorimit të përditshëm në 4 gjuhë: shqip, italisht, frëngjisht e anglisht.

⁹ Po aty, më 16.01.1910.

¹⁰ Po aty, nr. 7, dt. 13 Fruer 1910.

Si autor i një romani dhe i “Historiis s’Shqypniis” ku ka plot pasazhe letrare, Nikajn nuk kishte se si të mos ishte në krah të krijuesve, por edhe të mos e kuptonte se pena e shkrimtarit të njohur a debutant të mos sillte kërshtëri e interes, ndaj pas numrave të parë ai nis të botojë radhazi romanin e tij “Marcia”, duke vënë në fund të çdo pjesë të botuar shënimin “*Kaa maa*” (në kuptimin vijon në numrin e ardhshëm të gazetës-shënimi im, D.K.)

Zgjon interes një kryeartikull me titull “Shkrimtarët e huej e giûha Shqype”, firmosur me inicialin H. Përderisa në fund të çdo numri gazete nënshkruhet “Drejtuer e i Zoti i Fletores – D. Nnos Nikai”, na lë të kuptojmë që në paragrafin e parë se ky shkrim është i Dom Ndoc Nikajt dhe i askujt tjetër, përderisa vetëm një pronar e jo një inicial germe, mund t’i drejtohet lexuesit në atë lloj forme: “*Ndryshe une nuk po dii si me e fillue ket artikull, por...due me folun per disaa shkrimtaar t’huej, po, por që bane kndime t’kthella e punuene per giûhë t’onë e folne e shkruene per nee*”¹¹. Analiza që Nikaj i bën kontributit të tyre shkencor është një shembull i qartë se ai kish një njohje të plotë për veprat e Emile Legrandit e në veçanti për punën e tij të pareshtur për dhjetë vjet rresht për “Bibliografinë shqiptare”, ku përmendë “*emnat e gjithë saa librave n’saa giûhë kan dalë ç’n’fillim permii Shqypitarët e permii giûhen shqype*”. Solla një shembull, se kështu do të vijonim edhe me Gustav Mejerin, që përpos disa artikujve përmbi Shqipërinë e shqiptarët të botuara në të përkohshmet e mëdha të Europës, “*...kaa qitë: 1. Gramatikë e shkurtë e giûhës shqype* (gjermanisht), Lepipzig, 1888; 2. *Fialuer i fialve t’ giûhës shqype* (gjermanisht), Vjenë 1883-95; 3. *Fialuer i fialve t’ giûhës shqype* (gjermanisht), Strasburg, 1890.” Këtë rrjedhë njohjeje të lexuesve me shkrimtarë e shkencëtarë ai e vijon në po këtë shkrim, duke u ndalë kryesisht tek kontributi i Holger Perderonit e duke vijuar me P.Françesku da Lecce O.M.-gramatiken e giûhës s’onë e P. Rossi – fjalorin e saj shqyp-italisht e italisht-shqyp, P.Jungg S.I.-gramatiken e shqypes e shkrime të tjera”.

¹¹ Po aty, Vjeta I, Shkoder, 6 Nanduer 1910, nr. 45.

Lidhjet e gazetës "Bashkimi" me krijimtarinë letrare janë një "kapitull" më vete, pasi përmbajtja e tyre është e lidhur ngushtë me atdheun e bukurisë e tij, për të ngjallur përmes tyre ndjenjën kombëtare. Mjafton të sjellim dy poezi origjinale në gjuhën shqipe, për t'u bindur për këtë, atë me titull "Shqypniet", me nënshkrimin e autorit "Djali i Shqypniet" (mbase vetë Nikaj), por dhe "Kuitim" (kushtuar Elbasanit) por e nënshkruar K. Perdoda, një korrespondent i kësaj gazete që shfaqet edhe herëve të tjera, por me prirje krijuese.

Pas "Bashkimit" ai nxjerr dhe gazetën "Besa Shqiptare", që sigurisht që në titull nuk u binte për shtat pushtuesve serbo-malazezë e jo më në artikujt që përcillte tek lexuesit.

Me kurajon dhe iniciativën që e karakterizonte, nga të përjavshme, arriti shumë shpejt të themelonte e të nxirrte një tjetër gazetë, "Zanin e Shkoders" dy deri në katër herë në javë, e cila pat edhe jetëgjatësinë më të madhe, deri në vitin 1921¹².

*"Artikujt plot guxim dhe frymë shqiptare i shkaktuen shumë herë gjëritje të randa, burgime dhe kërcnime për vdekje"*¹³ – shkruan, mes tjerash autori i vëllimit "Shkrimtarë shqiptarë", Karl Gurakuqi, në zërin Ndoc Nikaj. Gjithashtu autori i këtij vëllimi, po aty, thekson se jo vetëm në gazetën e tij, por edhe në Bruksel, tek "Albania" e Faik Konicës, madje gati në çdo numër *"Dom Ndoci shkroi artikuj me përmbajtje politike, shoqërore dhe atdhetare, korrespondenca, vjersha me pseudonymin Nadomonic, të cilin e përjetësoi Fishta në poezin satyrike "Nakdomonicpedija", në librin "Anzat e Parnasit"*.

¹² Ndërsa që i arrestuar nga serbo-malazezët për botimin në gazetën e tij të një lajmi që u binte ndesh pushtuesve e pasi Nikaj kërkon dhe arrin të realizojë një takim me komandantin e kohës Boxho Petroviq, historia e ndërrimit të emrit të gazetës në "Kujtime t'një jetës së kalueme" (f. 141) përshkruhet kështu: *"Mbassi dola i lirë vazhdova me qitë gazetën "Besa Shqiptare", por ajo fjalë nuk i binte për shtat degave politike e policis e t'ushtris edhe më thirrte në polici ku më thane me i ndrrue emnin fletore. Po mirë, i thaçë. Po hjekë "Besa Shqiptare" e po la "Besa". Jo, më tha kryetari i policis. Pse jo, ju pergjegja. Besa asht një fjalë e pergjithshme që kanë të gjithë popujt e Botës. Po ju a nuk keni besë? Fjala kishte dy kuptime. Aj u kujtue po nuk pat çka me thanë. Ma vonë tha, po, ke të drejtë se fjala besë asht e pergjithshme, por ju Shqiptarët i nepni një kuptim të veçantë. Ujdisme me ja vue "Zani i Shkoders" e ashtu vazhdoj me dalë fletorja deri sa duel Mali i Zi e mbrapa e këtheva rishtas me titullin "Besa Shqiptare"*.

¹³ K. Gurakuqi: "Shkrimtarë...", SHB "Pakti", Tiranë, 2008, f. 87.

Po të shfletosh gazetën e Nikajt, e kupton edhe me të nuhatur se ajo është një organ politik, në të cilin rriheshin problemet më të mprehta të kombit shqiptar prej penave më të njohura të kohës, jo vetëm të Shkodrës, por të mbarë Shqipërisë”¹⁴.

Teksa Nikaj pat përfunduar një libër këndimi për mësonjëtores, ia kishin behur malazezët-pushtues në Shkodër, e bash në këtë kohë në fletoren e tij “Besa Shqiptare” publikoheshin artikuj kundër serbëve e malazezve, pa pyetur fare se çfarë e priste, mbase edhe të njëjtin fat fatal që patën dy gazetarë-patriotë, Muço Qulli e Çerçiz Topulli, që u arrestuan nga serbo-malazezët, u burgosën e më pas, teksa transportoheshin për në Cetinë, i pushkatuan në një anë rruge në të dalë të Shkodrës.

Nikaj nuk pat atë fat. I “pushkatuan” shkrimet me censurë, pasi para se ta nxirrte në treg fletoren e tij, i duhej ta dërgonte në policinë ushtarake pushtuese, e cila, si e lexonte, hiqte ato artikuj që direkt a indirekt e atakonin, ndaj dhe në disa numra të “Besës Shqiptare”, ka hapësira krejt të bardha, pra të censuruara nga pushtuesit. U arrit deri atje sa dhe të burgoset Nikaj për disa ditë e si kompensim lirimi t’i kërkohet t’i ndërrohet emri fletore. Me një konsensus, më shumë të imponuar si kusht lirimi, Nikaj pranoi emrin “Zani i Shkodrës”.

Duket se sa më shumë Shqipëria pas 1912-ës ka trazime politike e intervenime pushtuesish serbë, austro-hungarezë e francezë, aq më shumë vjen duke spikatur portreti atdhetar i Nikajt, e mbase dhe distancimi i tij nga petku fetar. Ka dhe kahje të theksuar kulturore, arsimore, letrare e ekonomike. Shtypshkronja e tij nuk i nxirrte fitime, mbijetonte vetëm duke iu afruar shpenzimeve që bënte.

Si u largua disi duhma e luftës e kur shkollat shqipe kishin më shumë se kurrë nevojë për libra e fletore, asokohe Luigj Gurakuqi, në cilësinë e drejtorit të përgjithshëm të mësonjëtoresve shqipe, i bën porosi Nikajt për të shtypur në shtypshkronjat e tij mijëra abetare, që i dha dorë Nikajt, më së pari që falë tirazhit të lartë ato libra t’i jepte me çmim të lirë, por dhe të shtonte fuqinë punëtore e të bënte porosira të reja jashtë shteti për germa të karaktereve të ndryshme,

¹⁴ A. Plasari: “Trembëdhjetë infraksionet e Dom Ndoc Nikajt”, faqe speciale në gazetën “55”, Tiranë, f. 10, e dielë, 5 maj 2002.

dore e kapitale, por dhe klisheve, të cilat, porositeshin e silleshin po nga jashtë e madje, disa sosh, edhe me çmime mjaft të kripura.

Mes morisë së problemeve atdhetare Nikaj arrinte të përcaktonte prioritetet e në këtë rast ishte ajo e shtypjes së librave e fletoreve për nivele të ndryshme të shkollimit të shqiptarëve në shkollat shqipe e mbase kjo që dhe arsyeja që edhe gazeta "Zani i Shkodrës", në trajtimet problemore, të mos kishte atë nivel të mëparshëm e në një format më të vogël.

Rruga publicistike e Dom Ndoc Nikajt, njohja e përditshme me ngjarje, personazhe, mjedise etj. qenë si përrënjtë që mbushin lumenjtë për veprat e tij të ardhshme romaneske, duke marrë një shkëlqim të ri. Por gjithsesi, edhe pse me zigzage të imponuara ndonjë herë nga koha e pushtuesit, fryma atdhetare e patriotike, por edhe shkencore e saj la gjurmë të pashlyeshme në publicistikën shqiptare e për këtë ajo e ne, më të rinjtë, i jemi mirënjohës.

BIBLIOGRAFI

- Dibra, Z., *Fjalor enciklopedik i hapsirës shkodrane* (II), SHB "Gjergj Fishta", Lezhë, 2016.
- Elsie, R., *Historia e letërsisë shqipe*, NBG-Dukagjini, Pejë, 1997.
- Fjalor Enciklopedik*, "Gazetarë dhe publicistë shqiptarë", Tiranë 2005.
- Fjalor Enciklopedik*, SHB "Bacchus", Tiranë, 2002.
- Gazeta (Fletorja) "KOHA", 1 kallnuer 1910.
- Gazetat "Bashkimi", "Besa Shqiptare", "Zani i Shkoders", vitet 1910-1921.
- Gurakuqi, K., *Shkrimtarë shqiptarë*, SHB "Pakti", Tiranë, 2008.
- Nikaj, N., *Kujtime t'nji jete t'kalueme*. SHB "Plejad", 2003.
- Osmani, T., *Tradita kulturore-gjuhësore në veprën "Kujtime t'nji jete t'kalueme" të Ndoc Nikajt*, Shkodër 2007.
- Plasari, A., *Trembëdhjetë infraksionet e Dom Ndoc Nikajt*, 2002.
- Revista "Phoneix", viti 2003, Shkodër.

